



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**KURRIKULA PËR SHKOLLAT ME DREJTIM
TË ORIENTUAR ARTISTIK**

ARSIMI I MESËM I LARTË

DEGA: ART FIGURATIV

LËNDA: GJUHË E HUAJ

KLASA: XII

Tiranë, 2018



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”
(klasa XII- Arsimi i mesëm i orientuar- shkollat ARTISTIKE)

| | | |
|-----|---|----|
| 1 | HYRJE | 3 |
| 2 | KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ E PARË” | 4 |
| 2.1 | Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj” | 7 |
| 2.2 | Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj” | 9 |
| 2.3 | Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj” | 13 |
| 2.4 | Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare | 21 |
| 2.5 | Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare | 22 |
| 2.6 | Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj” | 25 |
| 2.7 | Rezultatet e të nxënit | 27 |
| 2.8 | Ndarja e orëve mësimore | 37 |
| 3 | UDHËZIME METODOLOGJIKE | 38 |
| 4 | UDHËZIME PËR VLERËSIMIN | 40 |
| 5 | TABELA E NIVELEVE SIPAS KLASAVE | 44 |

1 HYRJE

Lënda “Gjuhë e huaj” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, etj) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale, emocionale dhe kulturore të nxënësit. Më konkretisht, lënda “Gjuhë e huaj”, e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhet individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Lënda ‘Gjuhë e huaj’ është pjesë e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t’u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv e i pavarur dhe shkruer i saktë, origjinal dhe krijues.

Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t’i fitojë gjatë procesit mësimor.

Njohuri është një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kriterëve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve, ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t’u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.

Shkathtësi është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës dhe energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.

Qëndrimet janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinionëve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).

Vlerat janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ato shprehen nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjyqimeve, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimit nxënësi është pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën, shoqërinë dhe për botën e punës. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi has sfida të reja dhe përdor aftësitë gjuhësore të fituara gjatë shkollimit për të reaguar në situata të njohura dhe jo të njohura për të si në klasë/shkollë ashtu edhe jashtë saj duke mbajtur qëndrime dhe zhvilluar vlera.

2 KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ E PARË”

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i kulturës së përgjithshme për Arsimin e Mesëm të Orientuar- shkollat artistike dhe sportive.

Programi shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, specialistët e arsimin dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxërë nxënësi dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësin me kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit. Ky program i ndihmon mësuesit të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies dhe të koordinojnë punën dhe përpjekjet e tyre për të përmbushur nevojat e nxënësit në të kuptuarin e lëndës dhe përdorimin praktik të saj edhe jashtë ambienteve shkollore, pasi mësuesit janë modele të cilat nxënësi ndjek në të ardhmen. Mësuesit do ta përdorin këtë program për të përcaktuar e monitoruar objektivat e vendosura për t'u përmbushur nga nxënësi në klasë, në shkollë si edhe në një raport më të gjerë.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin lëndor për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Shënim* : *Botuesit në përzgjedhjen e teksteve rekomandohen t'i referohen tabelës së vendosur në fund të programit e cila pasqyron përputhjen e niveleve gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe shtrirjen e tyre sipas klasave në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.*

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin lëndor për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj. Vlerësuesit e sistemit arsimor do të mbështeten në këtë program për të parë përmbushjen e standardeve lëndore të përcaktuara për këtë klasë.

Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Përfituesit e programit janë: nxënësit, prindërit dhe komuniteti.

Nxënësi përfiton të nxënit progresiv, zbaton shprehitë njohuritë, veprimtaritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën përkatëse dhe bëhet përdorues i mirë i gjuhës.

Prindërit dhe komuniteti mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.


Programi lëndor “Gjuhë e huaj” ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën e punës. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor dhe t'i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm.

Realizimi i programit në lëndën e gjuhës së huaj mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithëpërfshirës dhe të pasur me materiale të domosdoshme burimore duke përdorur sa më gjerë dhe në mënyrë efektive TIK.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe konsolidimin e kompetencave.

Gjithashtu programi i jep mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe inovativ në punën e tij duke përdorur metodat, strategjitë dhe përjasjet më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore në përqindje për njohuritë që do merren gjatë vitit shkollor.

Diagrami i mëposhtëm paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e Kornizës Kurikulare e cila synon një mësimdhënie me në qendër nxënësin, zhvillimin dhe përgatitjen e tij për t'u bërë anëtar i shoqërisë së dijes.



Diagrami 1: Korniza Konceptuale e Programit Lëndor “Gjuhë e huaj”

2.1 Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj”

Lënda e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të lartë ka si qëllim që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturës që studion siç janë institucionet shoqërore dhe politike;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme, për të hulumtuar dhe dhënë përgjigje e argumente për çështje të interesit të tij;
- të respektojë traditat dhe vlerat e kulturave të vendeve të ndryshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe të shkëmbejë informacione të detajuara mbi tema që paraqesin interes për të;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe në të njëjtën kohë formohet intelektualisht;
- të zhvillojë rrjedhshmërinë në gjuhën e huaj përmes praktikës së vazhdueshme të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e tij gjuhësor.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” për klasën XII, i hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar (viti 2000), si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit me qëllim që t’i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Ky program përfshin njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfituara ndër vite.

Programi shërben si bazë mbi të cilën hartohet Programi Orientues i Maturës Shtetërore si dokument i përshtatur nga ana didaktike, personale dhe profesionale dhe duke ju përgjigjur kërkesave gjithnjë e në rritje mbi njohjen dhe përdorimin e gjuhës së huaj. Programi në thelbin e vet mbart edhe kërkesat për cilësi gjithnjë e në rritje të vetë nxënësve; të ardhura këto nga përvojat e përdorimit të gjuhës së huaj për qëllime akademike ose punësimi.

Programi i gjuhës së huaj bazohet edhe në përvojat dhe rezultatet e nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore të viteve të mëparshme.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe ta edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulturash dhe aftësish.

Niveli i synuar në fund të klasës së 12 është B 2. Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B 2 i cili i referohet shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

| | | |
|------------------------------------|-------------------|--|
| <p>Përdoruesi i pavarur</p> | <p>B 2</p> | <p>Mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete dhe abstrakte duke përfshirë diskutime teknike në fushën e tij/saj të specializimit.</p> <p>Mund të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe spontanisht duke e bërë komunikimin me folës vendas të mundshëm pa vështirësi për secilën palë.</p> <p>Mund të prodhojë një tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash dhe shpjegojë pikëpamjet e tij/saj për një çështje të ditës, duke dhënë avantazhe dhe dizavantazhe për opsione të ndryshme.</p> |
|------------------------------------|-------------------|--|

Niveli gjuhësor i gjuhës së huaj, në klasën e XII të arsimit të mesëm të lartë në shkollat artistike dhe sportive, bazohet mbi njohuritë dhe konceptet e marra në klasat paraardhëse si dhe në konsolidimin e mëtejshëm të kompetencave kyçe dhe ato të lëndës për këtë shkallë. Nxënësi në këtë klasë forcon aftësinë e tij të të qenit i pavarur në përdorimin e gjuhës së huaj. Duke përparuar ngadalë por i sigurt përgjatë nivelit mesatar në vitet e mëparshme, nxënësi kupton se ka arritur shumë në përvetësimin e gjuhës së huaj dhe ka një perspektivë të re për të. Fokusi tani do të jetë argumentimi i ideve dhe opinionëve të tij. Si rezultat nxënësi jo vetëm do jetë në gjendje të marrë pjesë në një diskutim me temë të njohur për të por edhe të marrë iniciativën të fillojë një diskutim spontanisht, të përshtatet natyrshëm kur ndryshon tema e diskutimit dhe të mbrojë mendimet e tij me argumente. Gjithashtu nxënësi në këtë nivel ka një ndërgjegjësim më të lartë gjuhësor duke qenë në gjendje të korrigjojë gabimet e tij nëse ato çojnë në keqkuptime.

2.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës dhe të lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjithashtu e parë në kontekstin e anasjelltë nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyçe për të përmbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh kur nxënësi lexon një tekst ai nuk bazohet vetëm tek kompetenca gjuhësore por edhe tek kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare bazuar në llojin e tekstit që lexon, ose nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

Një tjetër shembull do të ishte edhe zhvillimi i një projekti gjatë orës mësimore. Nëse nxënësi bën një projekt si temë mësimore në këtë rast ai jo vetëm zhvillon kompetencat e tij gjuhësore, por gjithashtu kompetencat digjitale dhe qytetare, në varësi të tematikës që ai shtjellon.

Përjasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit pasi përdoruesi i gjuhës ose nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet veprimtarive gjuhësore të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përjasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përjasjeje çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë.

Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga njerëzit, të cilët si individë dhe si aktorë shoqërorë zhvillojnë një numër kompetencash kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme dhe kalon vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore të cilat përfshijnë proceset gjuhësore që mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave. Kjo përjasje ilustron në figurën e mëposhtme.



Figura 1: Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës së huaj


Kompetencat kyçe nuk lidhen vetëm me gjuhën por kanë të bëjnë me çdo lloj veprimtarie duke përfshirë edhe ato gjuhësoret.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat specifike të lëndës që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përshtat rezultatin/et e të nxënit për çdo fushë veprimtarie dhe mënyre të marrjes së gjuhës (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj);
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës të cilat së bashku i ofrojnë nxënësit informacionin në mënyrë efikase dhe bëjnë që nxënësi të përforcojë hap pas hapi arritjet e tij për të lexuar, shkruar dhe komunikuar duke i bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë.

Diagrami 2: Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”



2.3 Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj”

| |
|--|
| <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i> |
| Nxënësi: |

- shpreh para një audience të caktuar, çështjet thelbësore të ngritura në një fjalim ose në një interpretim për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes së paku një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike, etj.);
- diskuton në grup, në mënyrë konstruktive duke dhënë informacion, argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjuhën amtare ose në një gjuhë të huaj;
- lexon rrjedhshëm një tekst të panjohur në gjuhën e huaj, i cili përmban 2-3 faqe (tregim letrar, artikull gazete ose reviste, etj.), identifikon ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në strukturën e fjalive në gjuhën e huaj dhe në gjuhën amtare, duke nënvizuar dhe duke e ilustruar me shembuj konkretë;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj, në një numër të caktuar kontekstesh, si: ese, e-mail, letra formale dhe joformale etj.;
- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafësh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin, leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që mbart secili paragraf (teksti mund të jetë narrativ, përshkrues, artistik, etj.);
- prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe në mënyrë efektive komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediet e tjera të shkruara dhe elektronike;
- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim;
- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte, për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;
- përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënies (duke përfshirë edhe të nxënies në distancë) si dhe gjatë kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve ose para të tjerëve;
- analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë, p.sh., orientimi në karrierë, integrimi evropian, ndryshimet klimatike, rreziku nga armët konvencionale, armatimi bërthamor, zhvillimi kulturor-artistik në vend, etj.);
- gjykon rezultatet e arritura, nga analiza e të dhënave të një projekti apo programi të realizuar dhe i interpreton ato me gjuhën e matematikës dhe të fushës përkatëse, i paraqet grafikisht, në formë tabelore, duke nxjerrë përfundime të vërtetuara (p.sh., projekt me bazë shkolle, projekt për gjelbërimin, koncert, ekspozitë tematike, orë letrare, punë laboratorike etj.);
- hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë informative;
- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë;
- vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor dhe etnik etj.), identifikon elementet kryesore, i diskuton me moshatarët, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, duke shprehur qëndrimin personal;
- përpunon në mënyrë kritike, informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarët dhe me të tjerët për çështjen e ngritur, “pro” ose “kundër” (martesat mes anëtarëve të një gjinie, dënimi me vdekje etj.);
- argumenton rezultatet e arritura gjatë një eksperimentimi në shkollë apo diku tjetër, duke përshkruar qëllimin, hipotezën dhe mënyrën e vëzhgimit të dukurisë së manifestuar, rezultatet i paraqet në mënyrë tabelore dhe grafike;

- zbaton njohuritë dhe përvojën në kontekst të zgjidhjes së një problemi nëpërmjet veprimeve të përshtatshme, p.sh., përfshin të rinjtë në një debat për tema me interes shkencor, shoqëror, historik, kombëtar etj., vetëm pasi të jenë bërë përgatitjet e duhura dhe të jetë bërë informimi i të gjithëve.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi:

- demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve etj.);
- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore (ose një problem nga jeta e përditshme ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarët), tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla;
- shfrytëzon, në mënyrë të duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;
- bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit;
- paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri, etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve;
- shkruan një letër motivuese në të cilën arsyeton angazhimin e vet për pjesëmarrje në një prezantim ose konkurs nga një fushë e caktuar mësimore, duke vënë theksin në aftësitë dhe cilësitë personale;
- përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;

- vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, e qartësisë së mendimit, etj.;
- menaxhon në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e punës, etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

- përcakton prioritetet, jep zgjidhje cilësore për përmirësimin e mjedisit, si dhe zbaton parimet e tregut të lirë dhe të buxhetimit në situata të jetës reale;
- ndërmerr iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve, referuar projektit apo planit;
- argumenton me shembuj konkretë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimmarrjen personale referuar mundësive në dispozicion për arsimim/ trajnim të mëtejshëm, mundësive personale dhe financiare, si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës;
- planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuara, si p.sh., një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarët, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës;
- paraqet modelin e një drejtuesi të një ndërmarrjeje ose organizate, sipas imagjinatës personale dhe duke respektuar karakteristikat kryesore të një sipërmarrësi të suksesshëm;
- përdor aftësitë digjitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një mjedisi të biznesit), duke renditur të dhënat sipas nevojave dhe prioritetëve të ndërmarrjes ose organizatës;

- zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog, apo skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator etj.), si dhe tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe përdorimit të tyre;
- paraqet kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar;
- merr iniciativa të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.

Kompetenca personale

Nxënësi:

- demonstroi vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale;
- tregon shkathtësi në organizimin e lojës me të tjerët, garave sportive apo aktiviteteve kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme;
- shfaq në forma të ndryshme, empati për të tjerët, p.sh., merr pjesë në aktivitete bamirësie, ndihmon të moshuarit, të sëmurët, etj., dhe përvojat e tilla i prezanton para të tjerëve;
- paraqet, me gojë ose me shkrim, përparësitë e aktiviteteve fizike ditore për individin e shëndoshë dhe prezanton para të tjerëve qëllimet e vendosura për veten në këtë fushë (për aktivitetet fizike ditore) dhe nivelin e arritjes së tyre;
- zgjidh konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive, duke shqyrtuar alternativat, duke marrë vendime dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra;
- bën zgjedhje dhe merr vendime të duhura lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet në jetën e përditshme ose në situata dhe aktivitete mësimore;

- shfaq në forma të ndryshme, ndërgjegjësimit për menaxhimin e emocioneve, stresit dhe konflikteve në situata të jetës së përditshme apo në situata të improvizuara me karaktere të ndryshme historike, aktuale, sociale, etj.;
- prezanton në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh., në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen;
- shpreh në forma të ndryshme, qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

- prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit;
- harton një listë propozimesh për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut në një situatë të caktuar, i kategorizon propozimet sipas rëndësisë dhe urgjencës, duke veçuar argumentet kryesore që mbështesin qëndrimin e vet;
- prezanton në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;
- paraqet në forma të ndryshme të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- ilustron me shembuj nga jeta e përditshme, praktikat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve të shembujve ilustrues në këtë fushë;
- merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet, etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri;

- prezanton në një debat me të tjerët ose në një formë tjetër të të shprehurit, masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave dhe parimeve të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, duke veçuar shembuj konkretë të ndonjë aktiviteti (p.sh., aktivitete për promovimin e barazisë gjinore, shmangien ndaj paragjytimeve dhe diskriminimit, luftën ndaj varfërisë, etj.);
- ilustron me shembuj, zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose në nivel komuniteti, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar (p.sh., demonstroi mënyrën e ofrimit të ndihmës së parë në rastet e fatkeqësive natyrore ose njerëzore);
- merr pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e një aktiviteti (në shkollë apo në komunitet) për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe në mënyra të ndryshme kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të tij;
- ndërmerri apo udhëheq një aktivitet për vlerësimin e cilësisë dhe të saktësisë së informacioneve në një faqe *ëeb* që shfrytëzohet më shumë nga moshatarët, arsyeton aktivitetin dhe vlerësimin e bërë, ofron këshilla të mbështetura në etikën morale dhe profesionale për shfrytëzimin e përgjegjshëm të internetit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

- përdor programet e TIK-ut në mënyrë efektive për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënës, duke përfshirë edhe të nxënës në distancë;
- prezanton një projekt, duke përdorur sekuenca animimesh, videosh, figurash për demonstrimin e temave mësimore;
- vlerëson cilësinë e informacionit që gjen nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh;
- përdor sistemet e duhura kompjuterike (hardëare, softëare, netëorks dhe softet) si: Ëord Processing, Database, Poëer-Point, Publisher, Internet Explorer për përdorimin e TIK-ut në situata të ndryshme të të nxënës (ndërtimin e tabelave, grafikëve, diagrameve, vizatimin e një plani, përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve);
- është krijues në zbatimin e njohurive që përmbajnë shkencat kompjuterike dhe mediet digjitale;
- tregon rregullat e sigurisë që duhen zbatuar për të ruajtur privatësinë personale sipas kodit të etikës së komunikimit personal dhe në grup;

- është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces;
- ndërgjegjësohet mbi globalizmin dhe larminë e kulturave, duke shkëmbyer me nxënësit e vendeve të ndryshme përvojat e vendit tonë.

2.4 Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënit, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij. Në Kornizën Kurrikulare dhe në Kurrikulën Bërthamë të AML janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësi njohjen e vlerësimit të kulturës dhe traditës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore ku mësuesi mund të krijojë situata të të nxënit gjatë të cilave nxënësi shpreh në forma të ndryshme (ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme) mendimet e tij të pavarura dhe të mbështetura me argumente dhe shembuj nga jeta e përditshme.

Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësit për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët, me natyrën dhe për të promovuar detyrat dhe të drejtat e individit në një shoqëri të lirë dhe demokratike si dhe për të promovuar historinë e kulturën e kombit të tij dhe të vendit gjuhën e të cilit mëson.

2.5 Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare

Programi lëndor “Gjuhë e huaj” mbështetet në integrimin ndërlëndor. Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxëniet në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Nxënësi zgjeron fjalorin dhe zhvillon aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë në fushat e tjera.

Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (gjeografi, qytetari etj) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve dhe figurave historike si dhe të vlerave shoqërore. Me fushën shoqëria dhe mjedisi janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat etj.


Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatikisht të saktë.

Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori,shkenca, matematikë etj) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj. Integrimi i lëndëve të tjera në gjuhën e huaj ndihmon jo vetëm në lidhjen ndërlëndore por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti, mjedisi. Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën etj.. Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in,

programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj, ndihmon atë të eksplorojë të reja mbi botën që po studiojnë, të prezantojë sa më bukur

dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij dhe të marrë informacion në kohë reale. Më konkretisht, kjo lidhje jepet në diagramin e mëposhtëm.



Diagrami 3: Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare

2.6 Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

Kompetencat e komunikimit gjuhësor janë ato të cilat e fuqizojnë nxënësin të veprojë duke përdorur specifikisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore. Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit gjuhësor. Kompetenca e komunikimit gjuhësor është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, e njohurive se si gjuha përdoret në ambiente shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njohurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjërimit.

Përshkrimi i kompetencave të lëndës

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme:

Kompetenca gjuhësore nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.

Kompetenca socio-gjuhësore ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.

Kompetenca pragmatike ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj.).


Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:

- a. Rrjedhshmëria
- b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyçe dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj.). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathhtësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit. Një numër i kufizuar kompetencash i lejon nxënësit të kryejë një numër shumë të madh veprimtarish. Të kuptuarit e këtij dallimi është thelbësor për të bërë të suksesshëm procesin e të mësuarit dhe të nxënimit të gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvete përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pakontekstualizuar i kompetencave (si p.sh mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi.



Diagrami 4: Lidhja e kompetencave të lëndës “Gjuhë e huaj” me veprimtaritë, aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore

2.7 Rezultatet e të nxënimit

| KOMPETENCA | REZULTATET |
|------------|------------|
|------------|------------|

| | | |
|---|---|---|
| GJUHËSORE Nxënësi zotëron gjuhën në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të bëjë përshkrime të qarta, të shprehë pikëpamje dhe të zhvillojë argumente duke mos pasur vështirësi në gjetjen e fjalëve dhe duke përdorur forma dhe struktura të përbëra fjalish. | Fjalori | Nxënësi zotëron fjalor të pasur për tema të përgjithshme dhe ato që lidhen me fushën e tij të interesit. Nxënësi përdor formulime të ndryshme fjalish për të shmangur përsëritjet por akoma mund të vihen re momente hezitimi. Saktësia gjuhësore është në përgjithësi e lartë megjithëse mund të shfaqen momente konfuzioni pa ndikuar në komunikim. |
| | Saktësia gramatikore | Nxënësi tregon shkallë të lartë kontrolli gramatikor duke mos bërë gabime të cilat mund të çojnë në keqkuptime. |
| | Fonetika | Nxënësi ka fituar shqiptim dhe intonacion të qartë dhe të natyrshëm. |
| | Ortografia | Nxënësi shkruan në mënyrë inteligjente tekste të gjatë dhe të qartë duke zbatuar strukturën standarde të organizimit të paragrafëve dhe të gjithë tekstit. Drejtshkrimi dhe pikëzimi janë të saktë por mund të ketë shenja të influencës së gjuhës amtare. |
| SOCIO-GJUHËSORE | Aktet e ligjërit dhe komunikimit | Nxënësi me pak përpjekje merr pjesë dhe vazhdon një diskutim në grup edhe kur flitet shpejt dhe me shprehje idiomatike. Nxënësi gjithashtu diskuton me një folës vendas të asaj gjuhe duke mos shkaktuar keqkuptime dhe duke u shprehur në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve. |
| PRAGMATIKE | Fleksibiliteti | Nxënësi përshtatet kur në diskutim ndryshohet tema dhe stili duke përshtatur formulimet sipas rastit. |
| | Pjesëmarrja në bashkëbisedim | Nxënësi ndërhyr në mënyrë të përshtatshme në diskutime. Nxënësi fillon, vazhdon dhe përmbyll diskutimin në mënyrë efektive duke e marrë radhën aty kur duhet dhe në mënyrë të përshtatshme. |

| | | |
|--|--------------------------|--|
| | Zhvillimi i temës | Nxënësi tregon ose përshkruan në mënyrë të qartë duke zgjeruar dhe mbështetur pikat kryesore me shpjegime dhe shembuj të detajuar. |
| | Koherenca | Nxënësi përdor mjete të kufizuara lidhëse për të realizuar të folur të qartë dhe koherent. |

Aspektet cilësore të përdorimit të gjuhës së folur për nivelin B 2

| | Gama/diapazoni | Saktësia | Rrjedhshmëria | Ndërveprimi | Koherenca/ lidhja logjike |
|------------|---|--|---|---|---|
| B 2 | Zotëron mjaftueshëm fjalor për të qenë në gjendje të përshkruajë qartë, të shprehë pikëpamjet mbi tema të përgjithshme duke mos pasur nevojë të kërkojë për fjalë dhe duke përdorur forma të përbëra fjalish. | Tregon shkallë relativisht të lartë kontrolli. Nuk bën gabime që çojnë në keqkuptime dhe korrigjon shumicën e gabimeve të tij/saj. | Flet për një kohë të gjatë me ritëm të njëtrajtshëm megjithëse ndonjëherë heziton për të kërkuar shprehje dhe modele fjalish duke krijuar pauza të dukshme. | Mund të fillojë një diskutim, të ndërhyjë kur është e përshtatshme dhe të përfundojë diskutimin kur ai/ajo e shikon të nevojshme. Mund të shprehë konfirmim me të tjerët, t'i ftojë ata për të marrë pjesë në diskutim etj. | Mund të përdorë një numër të kufizuar të mjeteve lidhëse për ta bërë të folurën e tij/saj të qartë dhe koherente. |

Për përmbushjen e kompetencave të lëndës të cilat çojnë natyrshëm në forcimin e kompetencave kyçe, nxënësit i duhet të konsolidojë njohuritë dhe konceptet e duhura, të aftësohet në shkathtësitë e fituara dhe të mbajë qëndrime dhe të zhvillojë vlera në situata të ndryshme.

Njohuri dhe koncepte:

1. Formimi kulturor:

- a. **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë; çfarë dua unë për të ardhmen time; etj.*)
- b. **Bota e shkollës dhe e punës** (*organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj; studimet dhe universitetet në vend dhe në botë; etj.*)
- c. **Jeta personale dhe shoqërore** (*shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri; etj.*)
- d. **Bota rreth nesh** (*arti në shekuj; e ardhmja, flora dhe fauna; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; momente të rëndësishme të historisë botërore; personalitete në fusha të ndryshme të jetës; etj.*)
- e. **Bota e komunikimit** (*bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave- letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, ese; etj.*)

2. Formimi gjuhësor:

- a. **Gramatika** (*ndajfoljet e mënyrës, kohës etj; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e përbëra; format e përbëra të foljeve në kohë të tashme, të shkuar dhe të ardhme; ligjërrata e drejtë dhe e zhdrejtë në format e përbëra të foljeve; mënyra jo veprorë në format e përbëra të foljeve; foljet modale; fjalitë kushtore, nyjet, emrat etj*)
- b. **Funksionet gjuhësore** (*dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimit ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; sugjerime, ftesa etj.*)

Aftësi dhe shkathtësi:

Të dëgjuarit

Përshkrimi :

Nxënësi kupton idenë kryesore të një bisede kur flitet me një gjuhë të ndërlikuar por me dialekt standard për tema konkrete ose abstrakte në jetën e përditshme shoqërore, akademike ose profesionale duke përfshirë edhe diskutime teknike. Nxënësi ndjek linjën e argumentit në një fjalim të gjatë dhe kompleks kur tema është e njohur për të.

Nxënësi:

- kupton në detaje çfarë thuhet në gjuhën e folur standarde edhe në ambiente të zhurmshme;
- ndjek një leksion, kur tema është e njohur dhe prezantimi është i strukturuar në mënyrë të hapur dhe të qartë;
- kupton pjesën më të madhe të dokumentarëve në radio që përcillen në gjuhën e përditshme dhe mund të identifikojë gjendjen shpirtërore dhe tonin e folësit etj;
- kupton dokumentarët televizivë, intervistat direkt, diskutimet, dramat dhe pjesën më të madhe të filmave në një dialekt standard;
- kupton idetë kryesore të një bisede të ndërlikuar, qoftë me tema abstrakte apo konkrete që përcillen në një dialekt standard duke përfshirë diskutimet teknike në fushën e tij të dijeve dhe interesit;
- përdor një varg strategjish për të arritur të kuptojë çështjet kryesore në një pjesë që dëgjon duke përdorur të dhënat nga konteksti.

Të lexuarit**Përshkrimi:**

Nxënësi lexon në mënyrë të pavarur duke e përshtatur stilin dhe shpejtësinë e të lexuarit sipas llojit të tekstit dhe qëllimeve të tij dhe duke përzgjedhur burime reference të përshtatshme. Nxënësi ka fjalor aktiv të gjerë por mund të ketë vështirësi me shprehjet idiomatike që hasen rrallë.

Nxënësi:

- kupton menjëherë përmbajtjen dhe rëndësinë e lajmeve, artikujve dhe raporteve mbi temat brenda interesit të tij dhe të vendosë nëse një lexim më i detajuar është i nevojshëm.
- lexon dhe kupton artikuj dhe raporte rreth problemeve aktuale në të cilat autori shpreh qëndrime dhe pikëpamje të caktuara.
- kupton në detaje tekste brenda fushës së interesit ose zonës së specialitetit të tij profesional ose akademik.
- kupton artikuj të specializuar jashtë fushës së tij akademike apo profesionale duke përdorur fjalorin nëse është e nevojshme.
- kupton përmbledhje që kanë të bëjnë me tema kulturore si filma, shfaqje teatrale, libra dhe koncerte si dhe të përmbledh çështjet e tyre më kryesore.
- lexon letra rreth temave brenda fushave të tij të interesit profesional apo personal dhe kap çështjet më të rëndësishme.
- shqyrton shpejt një manual udhëzues (p.sh për një program kompjuteri), gjen dhe kupton shpjegime dhe këshilla referuese për një problem të caktuar.
- kupton në një prozë apo dramë motivet për veprimet e personazheve dhe si ndikojnë ato për zhvillimin e subjektit

Të folurit

Të folurit ndërveprues:

Përshkrimi:

Nxënësi flet rrjedhshëm dhe spontanisht duke mundur komunikim të rregullt dhe vazhdueshëm me bashkëfolësin pa shkaktuar keqkuptime. Nxënësi vë në dukje rëndësinë që kanë ngjarjet dhe përvojat e tij personale, prezanton pikëpamjet e tij qartë duke i mbështetur ato me detaje dhe argument.

Nxënësi:

- nis ose mbështet një bisedë të përgatitur ose intervistë;
- pyet nëse bashkëfolësi është i qartë dhe improvizon pyetje mbi tema interesante që mund të dalin gjatë një interviste;

- merr pjesë natyrshëm në një bisedë apo debat mbi një temë të përgjithshme;
- shkëmben informacion të detajuar faktik në fushën e tij të interesit;
- komenton opinionet e të tjerëve duke nxjerrë në pah avantazhet dhe disavantazhet e pikëpamjeve të tyre;
- merr pjesë në një diskutim dhe mbështet mendimin dhe pikëpamjet e tija duke komentuar dhe argumentuar;
- transmeton shkallë të ndryshme të emocionit dhe thekson rëndësinë e përvojave apo ngjarjeve.

Produkti i të folurit:

Përshkrimi:

Nxënësi bën përshkrime dhe prezantime të qarta dhe të detajuara për një gamë të gjerë temash të lidhura me fushën e tij të interesit duke zgjeruar dhe mbështetur idetë e tij me shpjegime të mëtejshme.

Nxënësi:

- jep përshkrime të qarta dhe të hollësishme mbi subjekte të ndryshme që lidhen me fushat e interesit;
- kupton dhe përmbledh gojarisht tekste të shkurtra të shkëputura nga mësimet e reja, intervista apo dokumentarë që përmbajnë opinione, argument dhe diskutime;
- kupton dhe përmbledh gojarisht subjektin letrar dhe vazhdimësinë e ngjarjeve në një pjesë të shkëputur nga një film ose teatër;
- shpjegon një pikëpamje mbi një çështje kryesore duke dhënë avantazhet dhe disavantazhet e zgjedhjeve të ndryshme;
- bën lajmërimi qartë, rrjedhshëm dhe në mënyrë spontane për tema të përgjithshme;
- përgatit dhe prezanton qartë duke dhënë arsyet dhe argumentet mbështetës të çështjes që prezanton;
- jep një sërë argumentesh të parashtruara mirë duke lidhur idetë e tija në mënyrë logjike;
- hamendëson rreth shkaqeve, pasojave dhe situatave të supozuara.

Të shkruarit

Përshkrimi:

Nxënësi shkruan tekste të qartë dhe të detajuar për tema të ndryshme që lidhen me fushën e tij të interesit duke vlerësuar dhe përmbledhur informacionin dhe argumentat të marra nga burime të ndryshme. Nxënësi gjithashtu shpreh në mënyrë efektive pikëpamjet e tij me shkrim.

Nxënësi:

- shkruan ese, raporte ose prezantime tekstesh qartë dhe të detajuar për tema që lidhen me fushën e tij të interesit;
- shkruan saktë dhe shkurt përmbledhje të artikujve mbi tema të përgjithshme;
- përmbledh informacion dhe argument nga media si dhe nga burime të ndryshme;
- trajton tema në një ese ose “letër një botuesi” duke dhënë arsye pro ose kundër një pikëpamjeje të caktuar;
- shtjellon një argument në një ese ose raport duke nxjerrë në pah problemet kryesore dhe duke përfshirë edhe detajet mbështetëse;
- shkruan rreth ngjarjeve ose përvojave të vërteta ose të sajuara në një mënyrë të detajuar dhe të thjeshtë për t’u lexuar;
- shkruan një artikull kritik për një film ose libër;
- shpreh ndjenja dhe qëndrime në një letër personale;
- raporton për të rejat e ditës duke bërë të qartë aspektet më të rëndësishme sipas mendimit tim për një ngjarje.

Vlera dhe qëndrime:

Nxënësi:

- komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët;
- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;
- respekton mendimin e të tjerëve;
- demonstroi vëmendje, respekt dhe keqardhje, kur të tjerët flasin;

- ndërmerr iniciativa dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënit;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton kulturën e vendit, gjuhën e të cilit mëson;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;
- është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- kritikon duke u mbështetur në argumente;
- tregon kureshtje për të kërkuar dhe hulumtuar njohuri të reja.

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikuese. Strategjitë konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me këto burime (veprimtari të komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Për shembull në një orë mësimi, një nxënësi i kërkohet të dëgjojë shpjegimin e mësuesit, të lexojë një tekst me zë ose në heshtje, të ndërveprojë me nxënësit e tjerë në grup, të shkruajë një ushtrim ose ese madje edhe të perifranojë, shpjegojë etj. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

| | |
|--|--|
| Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë prodhuese (produkti i të folurit/ produkti i të shkruarit) | |
| Planifikimi | Planifikon atë që do të thotë dhe mënyrat se si do ta shprehë duke konsideruar edhe efektin që do ketë tek marrësi i informacionit. |
| Kompensimi | Perifrazon për të plotësuar mangësitë që mund të ketë në fjalor ose strukturë fjalish. |
| Monitorimi dhe korigjimi | Korrigjon gabimet kur kupton se këto gabime kanë çuar në keqkuptime. Liston gabimet që bën më dendur dhe i monitoron ato gjatë të folurit ose të shkruarit. |
| Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë marrëse (të kuptuarit gjatë të dëgjuarit dhe të lexuarit) | |
| Identifikimi i të dhënave ndihmëse dhe gjetja e kuptimit | Përdor strategji të shumta për të kuptuar plotësisht duke përfshirë të dëgjuarin për idenë kryesore, të kuptuarin duke përdorur të dhënat e kontekstit. |
| Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë ndërvepruese (të folurit ndërveprues/ të shkruarit ndërveprues) | |
| Marrja e fjalës në bashkëbisedim | Ndërhyn në një diskutim në mënyrë të përshtatshme duke përdorur shprehjet e duhura gjuhësore. Fillon, vazhdon dhe përfundon diskutimin në mënyrë të përshtatshme. Fillon bisedën, merr fjalën në momentin e duhur dhe e përfundon bisedën kur e shikon të nevojshme. Përdor shprehje si “kjo është pyetje e vështirë për t’u përgjigjur” për të fituar kohë kur nuk gjen fjalën e duhur për të vazhduar. |
| Bashkëpunimi | Bën komente dhe ndjek linjën e diskutimit duke ndihmuar në vazhdimësinë e tij. Konfirmon që kupton dhe fton të tjerët të marrin pjesë në diskutim. |
| Pyetje për t’u qartësuar | Pyet për të parë nëse ka kuptuar çfarë po thuhet dhe kërkon sqarime për informacion të pa qartë. |

2.8 Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën e XII, sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit të Mesëm të orientuar-shkollat artistike dhe sportive.

Orët Mësimore 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë vjetore

| Klasa e XII | Formimi kulturor | Formimi gjuhësor | | Puna me portofolin | Totali i orëve |
|-------------|------------------|------------------|----------------------|--------------------|----------------|
| | | Gramatika | Funksionet gjuhësore | | |
| | 40% | 30% | 20% | 10% | 102 orë |
| | 41 orë | 31 orë | 20 orë | 10 orë | |

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përforsimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke pasur parasysh që përfaqja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënësve, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore ju referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Në klasën e 12 mësuesit duhet të planifikojnë në fund të vitit shkollor orë për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të gjuhës së huaj. Këto orë mund të merren si nga orët e formimit kulturor ashtu edhe nga orët e formimit gjuhësor.

Vlerësimi i nxënësit bëhet i mbështetur edhe në punët e tij të portofolit. Si rezultat del domosdoshmëri që mësuesi të planifikojë orë edhe për realizimin e projekteve dhe punëve të portofolit.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3 (tri) të cilat kryhen rreth përfundimit të çdo periudhe.

Planifikimi i orëve mësimore bëhet vjetor (sintetik- bëhet ndarja totalë e orëve) si edhe në bazë periudhash tre mujore (analitik- trajtohen temat për çdo orë mësimi).

3 UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçe dhe ato të lëndës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës. Metoda, strategji dhe teknika të tilla si: diskutim për njohuritë paraprake, diagram piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, puna në çift ose në grup etj., shërbejnë si nxitje për nxënësin dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përfaqja ndaj metodologjive të mësimdhënies dhe

mësimnxënies duhet të jetë shumë e gjerë dhe të paraqesë të gjitha mundësitë në mënyrë të qartë dhe transparente duke shmangur dogmatizmin. Mësuesi duhet të përdorë ato metoda që e ndihmojnë atë më shumë të arrijë përmbushjen e qëllimit final që është plotësimi i nevojave të nxënësit për t'u bërë një zotërues i mirë i gjuhës.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësi është në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësit. Nxënësit e një klase nxënë në mënyra të ndryshme: disa individualisht ose në grup, të tjerë nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur ose me anë të mjeteve të ndryshme didaktike. Përpos kësaj, lënda e gjuhës së huaj kërkon që nxënësi të nxërë konceptet, të zotërojë shprehitë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësit dhe nevojat e nxënësit. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarin bashkëveprues. Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh motivohet të punojnë më nxënësit e tjerë. Detyrat e përbashkëta i sigurojnë nxënësit më shumë kohë për të komunikuar dhe për të ndarë përvojat e tij me pjesëtarët e tjerë të grupit. Puna në grupe nxit respektin dhe tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për ndarjen e përgjegjësive dhe punës.

Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet duke forcuar më shumë lidhjen midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës.

Integrimi

Veprimtaritë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku për t'a bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të

përdorë njohuritë e marra në situatë të njohura dhe të panjohura për të dhe të zhvillojë aftësitë e tij të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të shkruarit.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë dhe shkathtësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njohura tek e panjohura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njohuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në faza të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

Situata e të nxënit

Mësuesi duhet të parashikojë situatë të nxëni që të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale. Kjo mund të zgjasë një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij.

Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- kompetencat e duhura;
- aftësinë për t'i përdorur këto kompetenca;
- aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

4 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencash. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësit (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësit në përmbushjen e kompetencave kyçe dhe ato të programit të lëndor për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e formimit dhe konsolidimit të kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë di aktualisht nxënësi;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet e tyre.

Tradicionalisht, tre koncepte konsiderohen nga më themelorët në vlerësim: vlefshmëria, besueshmëria dhe të qenit vlerësim i realizueshëm. Mësuesi duhet të ketë parasysh që në vlerësim të jetë i paanshëm dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësit ndahet në tre tipa kryesorë:

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që ka nxënësi rreth asaj për të cilën do të zhvillohet mësimdhënia gjatë vitit shkollor. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë që të përcaktohen strategjitë e të ardhmes. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi formues ose i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit, prindërit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit. Ky vlerësim mund të jetë edhe me simbole, komente etj.

Vlerësimi përmbledhës ose përfundimtar kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e fëmijëve të tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënies si dhe për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënies.

Gjatë zbatimit të programit nxënësit duhet t'i jepet mundësia të punojnë individualisht, në çift ose në grup për kryerjen e detyrave të dhëna dhe përmbushjen e kompetencave të lëndës dhe atyre kyçe. Në çdo rast mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënies në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave në klasë dhe jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Këto vlerësime bëhen në mënyrë të alternuar me njëri-tjetrin për t'i dhënë mundësi mësuesit të bëjë një vlerësim të saktë dhe të drejtë për të gjitha veprimtaritë gjuhësore. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënies dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënies. Praktikën e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxëniesi. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxëniesit për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në të mësuarin e gjuhës së huaj. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxëniesit në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
- nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe më pas mësuesi dhe nxënësi bëjnë komentin përfundimtar;
- nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;
- nxënësit mban shënime arritjet e tij duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- mësuesi bisedon me nxënësit individualisht dhe i tregon arritjet;
- nxënësi cakton objektivat për të ardhmen;

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi realizohet gjatë punës me portofolin e gjuhëve.

Vlerësimi me portofol lëndor (Portofoli Evropian i Gjuhëve)

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor, kontributeve dhe arritjeve të tij në gjuhën që po mëson, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.

Portofoli Evropian i Gjuhëve ka dy funksione: a. raportues dhe b. pedagogjik

Ai përbëhet nga tri pjesë:

- Pasaporta gjuhësore** ku nxënësi regjistron nivelet gjuhësore, kualifikimet dhe përvojat ndërkulturore.
- Biografia gjuhësore** ndihmon nxënësin të regjistrojë dhe të reflektojë mbi progresin e tij gjuhësor.
- Dosja** e cila mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore, certifikata, diploma etj.

Për informacion të mëtejshëm mbi vlerësimin mësuesi i referohet udhëzimeve përkatëse.

5 TABELA E NIVELEVE SIPAS KLASAVE

Tabela pasqyron përputhjen e niveleve gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe shtrirjen e tyre sipas klasave në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

| nivelet klasat | A 1 | A 2 | A 2+ | B 1 | B 1+ | B 2 |
|-------------------|-----|-----|------|-----|------|-----|
| Klasa 12 | | | | | | |
| Klasa 11 | | | | | | |
| Klasa 10 | | | | | | |
| Klasa 9 | | | | | | |
| Klasa 8 | | | | | | |
| Klasa 7 | | | | | | |
| Klasa 6 | | | | | | |
| Klasa 5 | | | | | | |
| Klasa 4 | | | | | | |
| Klasa 3 | | | | | | |